



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 18.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
<b>A. Informacioni bazë</b>			
Institucioni dhe tema	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Z. Izet Kadana		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Ky subjekt i nënshtrohet vlerësimit me short.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u shty për dhënien e vendimit për në datë 20 Dhjetor, ora 10:00, dhe trupi gjyqësor nuk paraqiti asnjë arsye për këtë shtyrje.		
lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës dëgjimore, në kundërshtim me nenin 55 pika 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve".		
<b>B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca</b>			
Trupi gjyqësor (emrat)	Lulzim Hamitaj, kryesues, Firdes Shuli, relatore dhe Xhensila Pine anëtare.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Z. Theo Jacobs		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Me avokat, Z. Tonin Prendi		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	7 anëtarë nga publiku. Seanca u monitorua edhe nga një vëzhgues i Avokatit të Popullit.		
Media e pranishme:	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u vu re një numër i vogël i përfaqësuesve të medias. Kështu, seanca u monitorua nga përfaqësues të medias së shkruar, (BIRN, dhe Gazeta Shekulli) dhe u vërejtën pak operatorë të medias që të kryenin video regjistrimin e çeljes së seancës dëgjimore.		
<b>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</b>	Po Rivlerësimi i këtij subjekti u krye mbi bazën e të tri kriterëve të parashikuara nga ligji.	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
<b>D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)</b>	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
	Në lidhje me këtë kriter, relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e vlerësimit të institucionit ndihmës, ILDKPKI, i cili ka konstatuar pozitivisht lidhur me deklarinimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave që justifikojnë pasuritë e subjektit, si dhe mungesën e situatës së konfliktit të interesit.	ILDKPKI	Po barra e provës u kalua sipas ligjit.

D1. Pasuria	<p>Në përfundim të hetimit të saj KPK ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit disponon pasuritë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Apartament banimi në qytetin e Pukës e blerë në vlerën 400,000 Lekë. Burimi i deklaruar nga subjekti janë të ardhura nga pagat dhe shitja e një dyqani në vlerën 600,000 Lekë.</li> <li>2. Autoveturë e tipit "Mercedes Benz" e blerë në vlerën 700,000 Lekë, deklaruar nga subjekti janë të ardhura nga pagat dhe kursimet deri në vitet 1993-2003.</li> <li>3. Automjet i tipit "Peugeot", e blerë nga bashkëshortja e tij në vitin 2012 me vlerë 3200 Euro, e deklaruar se është blerë me të ardhurat nga pagat.</li> <li>4. Gjendje kesh në vlerën 137,000 Lekë të deklaruara si të ardhura nga pagat dhe kursime ndër vite.</li> <li>5. Kredi në shumën 70 mijë Euro, e marrë nga Raiffeisen Bank në vitin 2013. Komisioni ka konstatuar deklaram të rremë të subjektit, pasi ai ka deklaruar se ajo është marrë në emër të një personi të tretë, por ajo figuron në emër të bashkëshortes së tij.</li> <li>6. Hua 140,000 Lekë dhënë në 2014 shtetasit A.P, e deklaruar se janë kursime nga të ardhurat nga pagat.</li> <li>7. Kredi konsumatore 700,000 Lekë nga Raiffeisen Bank për 2 vjet</li> </ol> <p>Analiza financiare KPK konkludoi se në bazë të analizës financiare të kryer të pasurive dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të ligjshme të subjektit rezultojnë me bilanc negativ për disa vite gjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar.</p> <p>Situatë konflikti interesi Në bazë të nenit 33 pika 5 shkronja "d" , Komisioni ka konstatuar se subjekti ka ushtruar rolin e tij në gjykimin e një çështje penale me të dëmtuar akuzues, me palë një person me inicialet A.P me të cilin ka pasur lidhje të ngushta shoqërore, dhe duke mos hequr dorë nga gjykimi i çështjes, ka rënë në situatën e konfliktit të interesit.</p>	Relatori	
	<p>Lidhur me kriterin e pasurisë, avokati mbrojtës u shpreh se ata kanë paraqitur argumentet dhe provat e tyre në kuadër të kalimi të barrës së provës. Ai u ndal në aspektet kryesore të mëposhtme:</p> <p>- Lidhur me kredinë në shumën 70 mijë Euro, marrë nga Raiffeisen Bank në vitin 2013, ai shpjegoi se ajo është marrë realisht për babain e bashkëshortes së subjektit, por në emër të kësaj të fundit për të përfituar lehtësi të interesave duke qenë se kjo e fundit ka qenë punonjëse e bankës në fjalë.</p> <p>-Lidhur me analizën financiare avokati mbrojtës saktësoi se gjendja e pasurisë së subjektit në vitin 2003 kur është bërë deklarimi i parë periodik, përfshinte të gjitha kursimet nga momenti i fillimit të marrëdhënieve të punë së subjektit, viti 1993. Subjekti ka pasur 700,000 Lekë kursime në ish Bankën e Kursimeve, sot Raiffeisen Bank që është provuar përpara komisionit.</p>	Mbrojtja	
	<p><u>Lidhur me situatën e konfliktit të interesit, subjekti Kadana, pasi i është kaluar barra e provës sipas ligjit ka sqaruar se marrëdhëniet e tij shoqërore me këtë person janë krijuar pas përfundimit të gjyqimit të çështjes, ku ai ka qenë palë.</u></p>	Subjekti	
	Asnjë	Ankesa nga publiku	
		ONM	
	Relatorja e çështjes shpjegoi se fillimisht DSIK i ka paraqitur Komisionit raportin ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit Izet Kadana për të vazhduar detyrën.	DSIK	Po barra e provës u kalua sipas ligjit.
<p>Ndërkohë, gjatë hetimit të saj, KPK ka siguruar disa dokumente, që kanë sjellë informacione shtesë edhe konfidenciale në bazë të cilave i ka kërkuar DSIK të kryejë rishikimin e vlerësimit të saj, pas së cilit ajo ka konkluduar me një raport të ri i cili ka konstatuar papërshtatshmërinë e këtij subjekti për të vazhduar detyrën, bazuar në:</p> <p>-përfshirja në aktivitetet kriminale të krimit të organizuar, të djalit të vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit Sh.K. i cili ka humbur jetën në Itali në vitin 2016, përfshirje në krimin e organizuar edhe të vëllait të subjektit, R.K, dhe djalit tjetër të tij shtetasit I.K. Aktiviteti kriminal është zhvilluar nga këta të fundit në disa qytete të Evropës. KPK konstatoi se vetë subjekti dhe djali i tij, I.K, kanë kontakte të ngushta me ta. . Këto fakte janë konfirmuar edhe nga subjektin në formularin e pastërtisë së figurës. Ndërkohë që edhe nipër të tjerë të subjektit nga vëllai tjetër, shtetasit A.K. F.K etj, kanë kryer vepra të tjera penale.</p> <p>KPK konkludoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe që mund të vihet nën presion nga krimi i organizuar.</p> <p>Gjithashtu, për këtë subjekt është paraqitur një ankesë nga shtetasja F.L e cila ka raportuar për 19 mesazhe sms të dërguara nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të saj në vitin 2015, ku ai ka përdorur fyerje dhe kërcënime ndaj saj, citoj "do ta tregoj unë ty se kush jam unë" .Lidhur me këtë incident subjekti ka marrë masë disiplinore nga KLD e cila është arshivuar për vlerësimin periodik të tij.</p> <p>KPK sqaroi me tej se në lidhje me një procedurë rekrutimi në Prokurorinë e Rrethit Pukë për pozicionin e kryesektetares subjekti ka influencuar në Prokurorinë e Përgjithshme, duke përdorur pozicionin e tij, për të përjashtuar nga kandidimi shtetasen F.L dhe favorizuar bashkëshorten e tij në këtë procedurë, e cila eventualisht është emëruar në atë pozicion.</p> <p>KPK konkludoi se subjekti ka kryer shkelje te etikës profesionale dhe ka abuzuar me pozicionin e tij.</p>	Relatori		

D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Në lidhje me kriterin e pastërtisë së figurës avokati mbrojtës i subjektit paraqiti argumentet e mëposhtme: -është e vërtetë që subjekti ka pasur kontakte me vëllain e tij R.K dhe djalin e tij Sh.K i cili ka humbur jetën, por këto kontakte kanë qenë vetëm në kuadër të ceremonisë së vdekjes së nipit Sh.K dhe për ndihmën që i është dhënë të vëllait R.K për kurimin e bashkëshortes nga një sëmundje e rëndë. Pas vdekjes së bashkëshortes së të vëllait në nëntor të vitit 2017 kontaktet me të vëllain R.K kanë qenë shumë të rralla, për raste përkujtimore dhe të rezervuara theksoi subjekti. Ai shtoi se i biri i tij, I.K, i ka ndihmuar me makinë vëllain e tij R.K për kurimin e të shoqes, dhe që nga vdekja e saj nuk ka shkuar më në shtëpinë e vëllait të tij R.K. Ai shtoi se tashmë djali i tij I.K jeton në shtëpinë e vëllait tjetër E.K.	Mbrojtja	
	Lidhur me veprimtarinë kriminale të nipërve të tjerë të subjektit, A.K dhe F.K., ai është shprehur se nuk ka dijeni për to. Lidhur me mesazhet jetike ndaj shtetas F.L ai pranoi se kishte gabuar dhe ishte ndëshkuar një herë për këtë. Ai shtoi se ishte i zhgënjyer nga kjo shtetase duke qenë se ai dhe bashkëshortja e tij kishin marrëdhënie të ngushta shoqërore me të.	Subjekti	
	KPK u shpreh se ka pasur 3 denoncime kundër subjektit por nuk kanë rezultuar se kanë sjellë fakte dhe rrethana të vlefshme për këtë proces.	Ankesa nga publiku	
	Vëzhguesi i ONM u shpreh jo më një pyetje por me një koment. Ai tha se sa i takon mesazheve drejtuar shtetas F.L në vitin 2015, ky është një rast i pastër i kërcënimit ndaj saj, si dhe hapat e ndërmarra në vijim nga subjekti lidhur me procedurën e rekrutimit në fjalë, janë veprime që shkojnë shumë më larg sesa kërcënimi dhe fyerja duke influencuar drejtpërdrejt në vendimmarrjen publike duke shfrytëzuar pozitën e tij për përfitime personale në dëm të kësaj shtetase.	ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Në raportin e saj KLD i ka vlerësuar të mjaftueshme aftësitë profesionale të subjektit në fjalë.	KLD	Po barra e provës u kalua sipas ligjit.
	Në lidhje me këtë kriter KPK u shpreh se në raportin e hollësishtëm të marrë nga Inspektorati i KLD, të gjitha aspektet e aftësive profesionale të subjektit janë vlerësuar pozitivisht, ndërkohë që nga hetimit i Komisionit janë konstatuar disa raste problematike për të cilat subjekti ka dhënë shpjegimet e tij dhe në i kemi marrë në konsideratë për vlerësimin përfundimtar.	Relatori	
	Në lidhje me këtë kriter subjekti i rivlerësimi u shpreh se ka pasur raste të gjykimet jashtë afatit për arsye të ngarkesës së punës së 3 dosje me një ditë vonesë. A theksoi se vendimet janë apeluar në të 2 shkallët më lart dhe janë lënë në fuqi nga to.	Subjekti, etj..	
		OMN	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme,	<p>Vihet re një vlerësim objektiv, i plotë, dhe proaktiv nga ana e KPK, bazuar në procedurat ligjore.</p> <p>Në lidhje me publicitetin e gjykimet.</p> <p>-Gjatë seancës dëgjimore kryesesi i trupës gjyqësore i kërkoi avokatit mbrojtës të fokusojë vetëm tek pikat kyçe dhe provat e reja, ndërkohë që publiku nuk është i njohur me argumentet e mbrojtjes së subjektit. Kjo çënon parimin publicitetit të seancës që duhet të diskutojë në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat dhe argumentet lidhur me çështjen, për t'i dhënë mundësi publikut të vlerësojë mënyrën se si KPK e administron procesin në fjalë.</p> <p>-Gjatë seancës dëgjimore nuk doli e qartë se cilat ishin veprat penale në të cilat ishin të përfshirë personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, përveç nenit 278 për armëmbajtje pa leje.</p> <p>-Gjithashtu në lidhje me 3 denoncimet e publikut nuk doli e qartë se çfarë përmbanin ato dhe pse ishin konsideruar pa vlerë për këtë proces.</p>		